


Austria dhe Hungaria 1850 – 1938

përpiluar nga redaktorët

Perandoria Austro-Hungareze | Austria | Hungaria

➤ *Gjithnjë e më shumë rregullore brenda monarkisë kufizonin mundësitë e romëve për të fituar për jetesë. Ndalesat ndaj udhëtimeve u pasuan nga vendosja me dhunë, regjistrimi gjithëpërfshirës dhe ndalesat e disa profesioneve. Vështirësitë ekonomike dhe propaganda Nationale Socialiste përkeqësoi situatën, dhe më në fund “puna e dhunshme, dëbimi dhe sterilizimi” do të zgjidhnin “çështjen Cigane” në kuadër të “zgjidhjes Nationale Socialiste”.*



POPULLSIA ROME
NË BURGENLAND NË VITIN 1927

Regjistrimi rigoroz mundësoi një mbikëqyrje të vazhdueshme dhe të afërt praktikisht të secilit person të etnisë rome.

III. 1

(bazuar nga Mayerhofer 1988, f. 40)



PARATHËNIE

“Politika Cigane” e Perandorisë Austro-Hungareze ishte përcaktuar nga kufizimet. Ndalesat ndaj udhëtimit, vendosja me forcë, ndalesat dhe dëbimet vazhduan traditën e përjashtimit dhe shtypjes që kishte vazhduar me shekuj—ku pika fillestare ishte arritja e parë e romëve në Evropën qendrore.

Fluksi i grupeve të romëve që shkuan nga lindja dhe juglindja kryesisht në Hungari, u perceptua si një “pushtim” dhe rezultoi në probleme serioze në mes të romëve dhe jo-romëve.

Kur qeveria austriake iu mbylli romëve kufirin hungarez, shumë romë u vendosën në pjesë shumë të varfra të Hungarisë perëndimore, sot të njohur si Burgenland. Kështu që, konfliktet ishin programuar në dekadat e para të shekullit të 20-të, që u shënuan me varfëri dhe luftë. “Ciganët” shiheshin si një “murta-jë” nga shumica e popullsisë, dhe më në fund si një “çështje” për të cilën vetëm një “zgjidhje” ishte e mundur në vitet e 1930-ta, fuqimisht e shënuar nga Socializmi Nacional.



III. 2

“Putri” me derë të drurit, dritare dhe oxhak, St. Margarethen, Burgenland, në mes të luftërave.

(nga Mayerhofer 1988, f. 177)

III. 3

Shtëpitë e romëve u regjistruan në Burgenland në vitet 1920-ta. Kjo kasolle mban numrin “28” mbi dritaren e majtë. Fotoja ishte bërë diku në vitin 1926.

III. 4

Vendosja në Mattersburg, Burgenland, në mes të luftërave. Piktura tregon tri dizajne të ndryshme të vendbanimeve që ekzistonin atëherë: majtas, një shtëpi e suvatur dhe e gëlqerosur prej tullave të baltës, në mes një “putri”, një kasolle gjysmë e futur në tokë, gjysmë e bërë nga druri, degët dhe balta, djathtas, një ndërtesë e mbushur me baltë, dhe gjysma e ndërtuar me trarë.



III. 3 (nga Mayerhofer 1988, f. 37)



III. 4 (nga Mayerhofer 1988, p. 184)

PERANDORIA AUSTRO-HUNGAREZE

Nga gjysma e dytë e shekullit të 19-të e më tej, grupet rome siç ishin Lovara, të cilat fillimisht kishin ardhur nga Principatat Danubiane dhe që tani kryesisht punonin si tregtarë kuajsh, erdhën në Hungari nga lindja. Sa më shumë grupe nomade shfaqeshin, aq më shumë ankesa regjistroheshin në “comitatuses” (regjionet hungareze). “Shkelja e përsëritur e ligjit” dhe mungesa e ligjeve që do të ndihmonin në trajtimin e kësaj „bezdie publike“ rezultoi në ankesa. Nga pikëpamja e popullsisë hungareze, imigrimi i romëve ishte një “pushtim”.

Një arsye tjetër për ankesa ishin ato rregullore të ligjeve distrikte të Hungarisë që obligonin komunat në gjetjen e akomodimit dhe furnizimin e romëve. Për shkak të shumë imigrimeve, këto rregullore ishin një barrë shtesë për qytetet.

Në vitin 1907, 28 distrikte kërkuan një mënyrë të standardizuar për tra-

jtimin e romëve; mirëpo, parlamenti nuk ishte në gjendje të gjente një zgjidhje politike. Përkundrazi, problemi u transferua në nivel administrativ. Vendimet që u morën, siç ishin ndalesa ndaj lypjes së lëmshës dhe riatdhesimi i detyruar në vendin origjinal të banimit, ishin në pajtim me “politikën Cigane” ekzistuese, bazuar në shtypje dhe kërcënime.

Kjo politikë hungareze, e vlefshme deri në vitin 1918, kishte për qëllim t’i detyronte romët të vendoseshin. Mirëpo, strukturat dhe mjetet ekonomike nuk ishin të mjaftueshme, dhe prandaj dështimi ishte paracaktuar. Qytetet nuk mund t’i ofronin romëve mjetet e nevojshme për mbijetesën ditore, kështu që ata shtyheshin të vazhdonin mënyrën e tyre “Cigane” të jetesës që të siguronin ekzistencën e tyre. Në të njëjtë kohë, paragjykimet e popullsisë shumicë dhe tendenca drejt kriminalizimit të romëve shtoheshin, më së paku për shkak të publikimeve për ligjin hungarez. Shteti dhe shoqëria nuk ishin në gjendje ose nuk dëshironin të merrnin masat e qëllimshme lidhur me romët. Kjo

rezultoi në ndryshime dramatike në distriktet e Hungarisë perëndimore (Burgenlandi i sotshëm): qeveria austriake kishte shtrenguar ligjet imigruese në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të në mënyrë që të ndalonte imigrimin e romëve. Në të njëjtën kohë, ajo dekretoi dëbimin e të gjithë romëve hungarez që gjendeshin në Austri. Në kombinim me ndalimin hungarez për largimin nga vendi, të dekretuar në Hungari në vitin 1870, kjo shpiti në një ngritje masive të numrit të romëve që jetonin në distriktet kufitare. Këto distrikte nuk kishin ose nuk dëshironin t’i akomodonin romët, prandaj këtyre të fundit iu dhanë ngastrat të pavlefshme të tokës për tu vendosur. Kjo është mënyra se si “kolonitë e turpshme Cigane” erdhën në ekzistencë në periferitë e qyteteve. [III. 2-4]

AUSTRIA

Një numër i madh i romëve dhe prapambetja ekonomike e regjionit të Hungarisë perëndimore e bëri integri-



III. 8 (Detaj) (përkthyer nga Mayerhofer 1988, f. 43f.)

Disa rregulla nga memorandumimi “Die Zigeunerfrage. Denkschrift des Landeshauptmanns für das Burgenland” (Çështja Cigane. Memorandumimi nga Kreu i Qeverisë së Provincës Burgenland) nga Thobias Portschy (Eisenstadt, 1938):

1. “Marrëdhënia seksuale në mes të Ciganëve dhe Gjermanëve përbën një shkëlqje të turpit racor.
2. Ciganët nuk lejohen të vijnë shkollën e përgjithshme fillore.
3. Sterilizimi i Ciganëve duhet të ndalojë riprodhimin e tyre.
4. Bastisjet e shtëpive dhe individëve duhet të bëhen rregullisht.
5. Kasollet e Ciganëve (një turp kulturor) duhet të rrëzohen, dhe Ciganët të vendosen në kasollet e kampeve punuese.
6. Në kampet punuese, Ciganët punojnë si grup i mbyllur.
7. Ushtrimi i profesioneve private jashtë kampit punues ndalohet.
8. Ciganët nuk lejohen të mbajnë armë.
9. Emigrimi vullnetar përkrahet.”

u mbajt në Oberwart me 15 qershor, 1933, u sugjerua që “ata të dërgoheshin në një ishull në Oqeanin e Qetë” ose të “tridheshin”.

Gjithashtu në Austria themeli për asgjësimin e romëve ishte vendosur në vitet dhe dekadat e mëhershme. Kërkesa e NSDAP, “që të bëhej një Burgenland i lirë nga Ciganët”, nuk ishte asgjë e re. Mirëpo, ndryshe nga politikanët e kohës së tij, “Gauleiter” (udhëheqësi i distriktit) ilegal i Socialistëve Nacional të Burgenlandit, Thobias Portschy ishte i vendosur ta realizonte planin e tij, “duke asgjësuar Ciganët “ përmes punës së dhunshme, dëbimit dhe sterilizimit, kështu duke gjetur një “zgjidhje socialiste nacionale” për këtë “problem”. [III. 8]

HUNGARIA

Në Hungari nuk mund të flasim në fakt për një “politikë Cigane” pas rënies së perandorisë. Qeveria kalimtare revolucionare, pas regjimit të Horthy, nuk i kushtonte shumë vëmendje romëve. Rregulloret e pakta që miratoheshin gjatë kësaj kohe kryesisht kishin për qëllim vëzhgimin e romëve dhe arsyetoheshin me shkallët ngritëse të krimit. Regjistrimi i romëve udhëtues, sikurse u dekretua në vitin 1928, dhe bastisjet e njëkohshme në disa distrikte ishin një risi.

“Strafrechtsnovelle” (amendamentet e ligjit penal) i dytë, në vitin 1928, përfshinte masa specifike kundër

të ashtuquajturve “kriminelë të pakorrigjueshëm”, për shembull transferimi i njerëzve të tillë në kampe punuese. Këto amendamente padyshim drejtëheshin kah romët, jeta e të cilëve, si doqoftë nuk ishte e ndryshme nga ajo e njerëzve të tjerë të nën privilegjuar. Në vitin 1931, Ministri i Punëve të Brendshme dekretoi që profesionet udhëtuese ishin gati tërësisht të ndaluar, dhe se leja e punës nuk ishte e vlefshme në distriktin e banimit – dhe ishte e lidhur me pëlqimin e këshillit të distriktit. Këto rregullore morën shumë burime të jetesës nga romët. Një dekret i miratuar në vitin 1938, sipas të cilit çdo romë duhej të konsiderohej si “i dyshuar” i mundshëm, vendosi themelin për persekutim dhe dëbim.

Bibliografia

Baumgartner, Gerhard (1987) Sinti und Roma in Österreich. In: Pogrom 130 (6/87), pp. 47-50 | **Baumgartner, Gerhard (ed.) (1995)** 6x Österreich. Zur Geschichte und aktuellen Situation der Volksgruppen. Klagenfurt-Celovec: Drava Verlag | **Fraser, Angus (1992)** The Gypsies. Oxford / Cambridge: Blackwell | **Mayerhofer, Claudia (1988)** Dorfzigeuner. Kultur und Geschichte der Burgenland-Roma von der Ersten Republik bis zur Gegenwart. Wien: Picus Verlag | **Szabó, Györgi (1991)** Die Roma in Ungarn. Ein Beitrag zur Sozialgeschichte einer Minderheit in Ost- und Mitteleuropa. Frankfurt am Main: Peter Lang (Studien zur Tsiganologie und Folkloristik, 5) | **Vossen, Rüdiger (1983)** Zigeuner. Roma, Sinti, Gitanos, Gypsies zwischen Verfolgung und Romantisierung. Frankfurt am Main: Ullstein